



Prishtinë / Priština  
Nr./Br. 1035-09

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 74.4, 74.5, 77.1 (d), 77.2, 77.3, 77.4 dhe 79.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.10.2009 nxjerr këtë:

#### VENDIM

##### Për emërimin e anëtarëve të KVV-ve për Zgjedhjet Komunale të 15 nëntorit 2009

- I. Miratohen rekomandimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve – KKZ për emërimin e anëtarëve dhe Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve – KVV për Zgjedhjet Komunale të 15 nëntorit 2009.
- II. Regjistri i anëtarëve, anëtarëve rezervë dhe Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve si në pikën I të këtij vendimi për 36 Komunitet të Republikës së Kosovës i është bashkangjitur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- III. Anëtarët e KVV-ve sipas përbërjes si në pikën II të këtij vendimi do të shërbejnë edhe në Raundin e II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave në Komunitetet përkatëse.
- IV. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së që përmes Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve – KKZ të ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e këtij vendimi.

Prishtinë, 21.10.2009

**Nesrin Lushta**

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve